

Titull: E Gabuar apo Ndryshe

Qëllimi:

Të mësojmë më tepër rreth mënyrës apo formës sesi i shikojmë të tjerët



Prezantimi:

Këtu do të marrim në konsideratë faktin nëse një ide është E GABUAR apo NDRYSHE dhe sesi ju ndiheni në lidhje me dy fjalët e sipërpërmendura.

Burimet:

Gërshërë
Ngjitës/Vinovil
Stilolapsa/Lapsa
Doracak 1
Doracak 2
Doracak 3

Udhëzime:

Merr një nga letrat prej tufës. A është kjo diçka që ti e quan normale? Nëse po, vëre sërish në tufë dhe përzgjidh një tjetër që nuk është "normale" për ty.

Ajo çka thuhet në letër është "E gabuar" apo "Ndryshe". Vendose letrën në tabelë për të treguar pikëpamjen tënde.

Afër me letrën tuaj apo ndonjë letre tjetër, si ndiheni kur e shihni këtë letër aty ku është vendosur?

Në vazhdim, ju mundet të diskutoni letrën dhe tabelën me dikë tjetër.

Diskutim:

Si e vendosni ju nëse diçka është: "E Gabuar" apo "Ndryshe"?

A ka letra në tabelë të cilat nuk të duken as "Ndryshe" e as "Të Gabuara" (ndoshta për ty janë normale)? Si ndihesh tek i sheh në tabelë?

Fjalët në tabelë janë ide tejet të thjeshta. Cilat janë disa nga bindjet apo sjelljet, për vendosjen apo përcaktimin e së cilave do të hasje vështirësi? Pse ndodh kjo?

Në jetën tuaj të përditshme, cilat janë disa nga situatat në të cilat ju silleni sikur format e të menduarit apo vepruarit të dikujt janë "Të Gabuara"? Po "Të Ndryshme"?



POP-UP FESTIVAL